

KTHEJI LËKURËS SHKËLQIMIN! BËJE ME “GERNETIC”!

Gjatë verës bëmë të pamundurën për t'i dhënë lëkurës nxirjen perfekte të bronzit. Në vjeshtë gjithçka i rikthehet normalitetit – edhe lëkura jonë, e cila, për shkak të ekspozimit të gjatë në diell, është e thatë dhe pa shkëlqim. Por mos u shqetësoni! Estetistja Maria, nga “Joyel SPA”, nëpërmjet trajtimeve me oksigjen dhe prodhimeve fantastike të “Gernetic”, premtan rezultate mahnitëse brenda pak ditësh



Cilat janë disa nga trajtimet e reja që ofron qendra “Joyel SPA” këtë sezon?

Kush ka shijuar në maksimum rrezet e diellit këtë vit, me siguri nuk u ka shpëtuar edhe efekteve negative të tij, që bëhen të dukshme sapo troket vjeshta dhe njerëzit i rikthehen normalitetit pas pushimeve dhe ditëve të tejzgjatura me diell. Lëkura e djegur, një ndjesi thatësie e lëkurës, janë shqetësimet e para të njerëzve që janë ekspozuar shumë në diell. Por nuk ka asgjë për t'u alarmuar, gjithçka e ka një zgjidhje. Për këtë, jemi ne! Për t'ju prezantuar “Trajtimin me oksigjen të ftyrës dhe trupit”.

Çfarë janë trajtimet me oksigjen?

Niveli i oksigjenit në lëkurë zvogëlohet ndjeshëm nga faktorë të tillë, si: moshë, pirja e duhanit, ekspozimi në ajër të ndotur. Mendohet se niveli i oksigjenit, që arrin në indet e ftyrës nëpërmjet qarkullimit të gjakut, mund të bjerë deri në 70% që në moshën 30-vjeçare... Me fjalë të tjera, sa më pak oksigjen të qarkullojë në lëkurën tuaj (ose, për të qenë të saktë, në epidermë që është shtresa e sipërme e lëkurës), aq më të dukshme bëhen rrudhat dhe shenjat e tjera të plakjes. Trajtimi me oksigjen në ftyrë e hidraton lëkurën, e ushqen me vitamina dhe antioksidantë, ndërsa presioni dhe serum i ndihmojnë në mbushjen e lëkurës, duke minimizuar shfaqjen e rrudhave. Njëkohësisht nxisin prodhimin e kolagenit, i cili ndihmon lëkurën të duket më e re, lufton njollat, qukat etj. Një pastrim me oksigjen lufton bakteret që gjenden në sipërfaqen e lëkurës, duke e ndihmuar atë të qëndrojë e pastër.

Çfarë përfitojmë nga oksigjeni i ftyrës?

Përfitimet nga trajtimet me oksigjen janë të ndryshme, duke filluar nga pastrimi i poreve e deri në luftën kundër pigmentimit të madh të lëkurës. Oksigjeni forcon elasticitetin e lëkurës, lufton bakteret përgjegjëse për krijimin e akneve, rrudhat dhe shenjat e tjera të moshës, si dhe zvogëlon porët. Efektet e oksigjenit zgjasin rreth dy ditë. Për rezultate më të mira, këshillohet një seri prej gjashtë trajtimitesh, gjatë një kohe prej një jave, e cila vijon me ekzaminime më të specializuara

mujore. Por trajtimet tona nuk mbështeten vetëm te pajisjet teknike, të cilat vërtet ndihmojnë dhe japin rezultat pas çdo seance, por gjithashtu ne i kombinojmë me produktet më të mira nga “Gernetic”, duke dhënë rezultate maksimale, në mënyrë që klientët tanë të mbeten të kënaqur.

Cilat janë disa nga këto produkte?

Produktet e “Gernetic” përfshijnë një gamë të gjerë për:

- 1) ftyrën, duart, bustin, trupin;*
- 2) trajtime për probleme të lehta të ftyrës, që mund të trajtohen edhe në shtëpi;*
- 3) probleme më specifike;*
- 4) produkte me përbërës aktivë.*

Kur aplikojmë trajtimet me oksigjen, për të arritur rezultate sa më të mira, ne e vazhdojmë procedurën me aplikimin e një serumit ose kremi. Për ne, siç thashë edhe më lart, është shumë e rëndësishme që klientët të mbeten të kënaqur. Disa nga produktet që përfshijnë në trajtimet me oksigjen janë: balsam dhe xhel konturues për sytë, kremrat “Hydra Ger” dhe “Ger Oxy”.

Balsami për sytë është një maskë fantastike që i bën sytë të shkëlqejnë. Është shumë efikas kundër fryrjes dhe rathëve të zinj poshtë syve. Aplikohet dy herë në javë.

Xheli konturues për sytë është një xhel me antiradikale, i cili ka veti hidratuese dhe përdoret në zonën përreth syve. Gjithashtu, mund të përdoret për pjesën e qafës dhe buzët. Xheli stimulon rritjen e qelizave dhe lufton rrudhat. Duhet të përdoret çdo ditë.

“Vasco” është një krem që ndihmon në korigjimin e problemeve me kapilarët e gjakut dhe për lëkurën me njolla. Ai bën që kapilarët të funksionojnë më mirë, duke forcuar muret e tyre dhe duke u rritur elasticitetin. Mund të përdoret edhe si anti-inflamator.

“Hydra Ger” përdoret si maskë ftyrë. Përmban aminoacide, të cilat lejojnë qelizat bazale të ruajnë lagështinë nëpërmjet ruajtjes së molekulave të ujit. Përdorimi i maskës heq menjëherë shenjat e lodhjes, sepse stimulon metabolizmin qelizor dhe minimizon rrudhat.

“Ger Oxy” është një krem me mbrojtje SPF 5, i cili mbron lëkurën e ndjeshme ose të prekur nga ndotja. Vepron si hidratues dhe mbrojtës. “Ger Oxy” aktivizon qarkullimin dhe mikro-rritjen e oksigjenimit, duke i dhënë ajër qelizave të lëkurës, të cilat ngadalësojnë procesin e plakjes. Efektet e oksigjenit të ftyrës zgjasin dy ditë. Për rezultate më të mira, rekomandohet një seri prej gjashtë trajtimitesh gjatë një periudhe kohore prej gjashtë javësh.